

VENDIM
Nr.350, datë 13.6.2006

**PËR HAPJEN E VENDKALIMIT TË RI KUFITAR, SHKODËR (URA E BUNËS), NË
KUFIRIN SHTETËROR LIQENOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME REPUBLIKËN
E MALIT TË ZI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 24 të ligjit nr.8772, datë 19.4.2001 “Për ruajtjen dhe kontrollin e kufirit shtetëror të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen e vendkalimit të ri kufitar, Shkodër (Ura e Bunës), në kufirin shtetëror liqenor të Republikës së Shqipërisë me Republikën e Malit të Zi, për komunikimin sezonal ndërkombëtar për turistë.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha